

Politika e privatësisë

I nderuar vizitor i i faqes sonë zyrtare në internet,

Ne ju falënderojmë për interesin e treguar ndaj nesh. Mbrojtja e të dhënave është një prioritet i lartë për drejtuesit e ProCredit Bank Shqipëri, me adresë në Rr. Dritan Hoxha, Nd.92, H.15, Njësia Bashkiake Nr.11, Tiranë, Shqipëri ("**ProCredit Bank**").

Tel: +355 4 2 389 389

e-mail: informacion@procredit-group.com

website: www.procreditbank.com.al

Përdorimi i faqeve të internetit të ProCredit Bank është i mundur pa implikim të përdorimit të të dhënave personale; megjithatë, nëse një subjekt i të dhënave dëshiron të përdorë shërbime të veçanta të Bankës nëpërmjet faqes sonë të internetit, përpunimi i të dhënave personale mund të bëhet i nevojshëm. Nëse do të nevojitet përpunimi i të dhënave personale dhe nuk ka bazë statusore dhe ligjore për këtë përpunim, në përgjithësi ne marrim pëlqimin nga subjekti i të dhënave.

1. Kukit (Cookies)

Faqet e Internetit të ProCredit Bank përdorin kuki. Kuki janë skedarë teksti që ruhen në një sistem kompjuterik nëpërmjet një shfletuesi të internetit.

Shumë faqe interneti dhe serverë përdorin kuki. Shumë kuki përmbajnë një kod identifikimi të vetë kukit. Kodi i identifikimit të kukit është kodi unik identifikues i kukit. Ky kod përbëhet nga një varg karakteresh përmes së cilës faqet e Internetit dhe serverët mund të caktohen në një shfletues të posaçëm të Internetit në të cilin është ruajtur kuki. Kjo bën të mundur dhe lejon që faqet internetit të vizituara dhe serverët të dallojnë shfletuesin individual të subjektit të të dhënave nga shfletues të tjerë të internetit që përmbajnë kuki të tjera. Një shfletues i veçantë i internetit mund të njihet dhe identifikohet nëpërmjet përdorimit të kodit unik të identifikimit të kukit.

Përmes përdorimit të kuki-t, ProCredit Bank do të mund t'u ofrojë përdoruesve të kësaj faqeje interneti shërbime më miqësore të cilat nuk do të ishin të mundshme pa vendosjen e dhe konfigurimin e kuki-t.

Me anë të një kuki, informacioni dhe ofertat në faqen tonë të internetit mund të optimizohen duke patur në fokus përdoruesin. Kuki-t na lejojnë, siç u përmend më lart, të njohim përdoruesit e i faqes sonë zyrtare në internetit tonë. Qëllimi i kësaj njohje është që të lehtësojë përdorimin e i faqes sonë zyrtare në internetit tonë për përdoruesit. Përdoruesi i faqes tonë të internetit që përdor kuki, p.sh. nuk duhet të vendosë të dhënat e aksesit sa herë që akseson faqen e internetit, sepse kjo është marrë nga faqja e internetit dhe kuki ruhet rrjedhimisht në sistemin kompjuterik të përdoruesit.

Subjekti i të dhënave në çdo kohë mund të parandalojë vendosjen e kuki-ve nëpërmjet faqes tonë të internetit me anë të një konfigurimi korrespondues të shfletuesit të internetit që përdoret dhe kështu mund të mos lejojë përgjithmonë vendosjen e kuki-ve. Për më tepër, kuki-t që tashmë janë vendosur mund të fshihen në çdo kohë nëpërmjet një shfletuesi të internetit ose programeve të tjera softuer. Kjo është e mundur në të gjithë shfletuesit e internetit. Nëse subjekti i të dhënave çaktivizon vendosjen e kuki-ve në shfletuesin e Internetit që është përdorur, jo të gjitha funksionet e faqes sonë të internetit mund të jenë plotësisht të përdorshme.

2. Mbledhja e të dhënave dhe informacionit të përgjithshëm

Faqja e internetit të ProCredit Bank mbledh një sërë të dhënash dhe informacione të përgjithshme kur një subjekt i të dhënave ose një sistem i automatizuar thërret faqen e internetit. Këto të dhëna dhe informacione të përgjithshme ruhen në skedarët e evidencës së serverit. Të dhënat që mbledhen mund të jenë (1) llojet e shfletuesit dhe versionet që përdoren, (2) sistemi operativ që përdoret nga sistemi i aksesit, (3) faqja e internetit nga e cila një sistem aksesues arrin në faqen tonë të internetit (të njohur me emrin referues), (4) nën-i faqes sonë zyrtare në internetet (5) data dhe koha e aksesit në faqen e internetit, (6) një adresë protokollit të internetit (adresa IP), (7) ofruesi i shërbimit të internetit të sistemit të aksesit dhe (8) të dhëna të tjera të ngjashme dhe informacione që mund të përdoren në rast të sulmeve ndaj sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Gjatë përdorimit të këtyre të dhënave dhe informacione të përgjithshme, ProCredit Bank nuk nxjerr asnjë konkluzion rreth subjektit të të dhënave. Përkundrazi, ky informacion është i nevojshëm dhe mundëson: (1) sigurimin e përmbajtjes së faqes tonë të internetit në mënyrë korrekte, (2) optimizimin e përmbajtjes së faqes sonë të internetit, si dhe reklamën e saj, (3) siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemeve tona të teknologjisë së informacionit dhe teknologjisë së faqes sonë zyrtare në internetit, dhe (4) u sigurojmë autoriteteve ligj zbatuese informacionin e nevojshëm për ndjekje penale në rastin e një sulmi kibernetik. Prandaj, ProCredit Bank analizon statistikisht të dhënat dhe informacionet e mbledhura në mënyrë anonime, me qëllim rritjen e mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së të dhënave të shoqërisë sonë dhe për të siguruar një nivel optimal të mbrojtjes së të dhënave personale që ne përpunojmë. Të dhënat anonime të skedarëve të evidencës ruhen veçmas nga të gjitha të dhënat personale të dhëna nga një subjekt i të dhënave

3. Dispozitat e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me aplikimin dhe përdorimin e Google Analytics (me funksion anonimiteti)

Në këtë faqe interneti, ProCredit Bank ka integruar komponentin e Google Analytics (me funksionin anonim). Google Analytics është një shërbim analizues uebi. Analizimi i uebit është mbledhja, grumbullimi dhe analiza e të dhënave për sjelljen e vizitorëve në faqet e internetit. Shërbimi i analizës së internetit mbledh, ndër të tjera, të dhëna për faqen e internetit nga e cila ka ardhur një person (e njohur si referues), cilat nën-faqe janë vizituar, ose sa shpesh dhe kohëzgjatja e vizitës në një nën-faqe. Analizat e uebit përdoren kryesisht për optimizimin e një faqe interneti dhe për të kryer një analizë kosto-fitim të reklamimit nëpërmjet Internet.

Operatori i komponentit të Google Analytics është Google Inc., 1600 Amphitheatre Pkwy, Mountain View, CA 94043-1351, Shtetet e Bashkuara.

Për analizën e uebit nëpërmjet Google Analytics, ProCredit Bank përdor aplikacionin "_gat._AnonymizeIp". Me anë të këtij aplikacioni, adresa IP e lidhjes në internet të subjektit të të dhënave shkurtohet nga Google dhe ruhet anonimati gjatë aksesimit të faqeve tona të internetit.

Qëllimi i komponentit të Google Analytics është të analizojë trafikun në faqen tonë të internetit. Google përdor të dhënat dhe informacionin e mbledhur, ndër të tjera, për të vlerësuar përdorimin e faqes sonë të internetit dhe për të siguruar raporte në internet, të cilat tregojnë aktivitetet në faqet tona të internetit si dhe për të na ofruar shërbime të tjera në lidhje me përdorimin e faqes sonë të internetit.

Google Analytics vendos një kuki në sistemin e teknologjisë së informacionit të subjektit të të dhënave. Përkufizimi i kukit është shpjeguar më sipër. Me vendosjen dhe konfigurimin e kukit, Google ka mundësi dhe arrin të analizojë përdorimin e faqes sonë të internetit. Me çdo thirrje të një

nga faqet individuale të këtij sajti internet, shfletuesi i internetit në sistemin e teknologjisë së informacionit të subjektit të të dhënave automatikisht do të dërgojë të dhëna përmes komponentit të Google Analytics për qëllime reklamimi në internet dhe pagesën e komisioneve për Google, nëse është e aplikueshme. Në kuadrin e kësaj procedure teknike, kompania, Google, fiton njohuri në lidhje me informacionin, siç është adresa IP (e shkurtuar) e subjektit të të dhënave, e cila i shërben Google, ndër të tjera, për të kuptuar origjinën (vendin, rajonin) e vizitorëve dhe klikimet.

Kuki përdoret për të ruajtur informacione të tilla si koha e aksesit, vendi nga i cili është bërë aksesi dhe frekuenca e vizitave në faqen tonë të internetit nga subjekti i të dhënave. Me çdo vizitë në faqen tonë të internetit, të dhëna të tilla, përfshirë adresën IP (të shkurtuar) të aksesit në internet që është përdorur nga subjekti i të dhënave, do të transmetohen në Google në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto të dhëna ruhen nga Google në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Google mund t'i kalojë këto të dhëna të mbledhura përmes procedurës teknike palëve të treta.

Subjekti i të dhënave, sikundër u deklarua më sipër, mund të parandalojë vendosjen dhe konfigurimin e kuki-ve nëpërmjet faqes sonë të internetit në çdo kohë me anë të rregullimit korrespondues të shfletuesit që është përdorur dhe në këtë mënyrë nuk lejon përgjithmonë vendosjen dhe konfigurimin e kudit. Një rregullim i tillë në shfletuesin e internetit që përdoret do të parandalonte gjithashtu që Google Analytics të vendoste një kuki në sistemin e teknologjisë së informacionit të subjektit të të dhënave. Përveç kësaj, kudit që tashmë përdoren nga Google Analytics mund të fshihen në çdo kohë nëpërmjet një shfletuesi të internetit ose programeve të tjera softuer.

Gjithashtu, subjekti i të dhënave ka mundësi të kundërshtojë mbledhjen e të të dhënave që gjenerohen nga Google Analytics, të cilat lidhen me përdorimin e kësaj faqeje interneti, si dhe përpunimin e këtyre të dhënave nga Google dhe mundësinë për të parandaluar ato. Për këtë qëllim, subjekti i të dhënave duhet të shkarkojë një shtojcë të shfletuesit nën URL <https://tools.google.com/dlpage/gaoptout> dhe duhet ta instalojë atë. Kjo shtesë e shfletuesit i tregon Google Analytics përmes një JavaScript, që çdo informacion dhe të dhëna për vizitat në faqet e internetit nuk mund të transmetohen në Google Analytics. Instalimi i shtesave të shfletuesit konsiderohet si një kundërshtim nga Google. Nëse sistemi i teknologjisë së informacionit të subjektit të të dhënave fshihet më vonë, formatohet ose instalohet sërish, atëherë subjekti i të dhënave duhet të instalojë përsëri shtesat e shfletuesit për të çaktivizuar Google Analytics. Nëse shtesa e shfletuesit është çinstaluar nga subjekti i të dhënave ose ndonjë person tjetër i cili i atribuohet fushës së kompetencës së tyre ose është çaktivizuar, atëherë është e mundur të kryhet riinstalimi ose riaktivizimi i shtesave të shfletuesit.

Informacione të mëtejshme dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave të Google mund të merren në linkun: <https://www.google.com/intl/en/policies/privacy/> dhe tek <http://www.google.com/analytics/terms/us.html>. Google Analytics shpjegohet në vijim në linkun e mëposhtëm <https://www.google.com/analytics/>.

4. Regjistrimi në faqen tonë zyrtare në internet

Subjekti i të dhënave ka mundësi të regjistrohet në faqen e internetit të ProCredit Bank me të dhënat personale. Se cilat të dhëna personale transmetohen tek ne, përcaktohen nëpërmjet maskës hyrëse përkatëse që përdoret për regjistrimin. Të dhënat personale që regjistrohen nga subjekti i të dhënave grumbullohen dhe ruhen ekskluzivisht për përdorim të brendshëm nga banka ProCredit dhe për qëllimet e veta. ProCredit Bank mund të kërkojë transferim tek një ose më shumë përpunues

/procesor (p.sh. një shërbim postar) i cili gjithashtu përdor të dhëna personale për një qëllim të brendshëm që i atribuohet ProCredit Bank.

Duke u regjistruar në faqen e internetit të ProCredit Bank, ruhet edhe adresa IP-së, që është caktuar nga ofruesi i shërbimit të internetit (ISP) dhe që përdoret nga subjekti i të dhënave dhe koha e regjistrimit. Ruajtja e këtyre të dhënave bëhet në bazë të faktit se kjo është mënyra e vetme për të parandaluar keqpërdorimin e shërbimeve tona dhe, nëse është e nevojshme, për të bërë të mundur hetimin dhe investigimin e veprave penale që janë kryera. Deri tani, ruajtja e këtyre të dhënave është e nevojshme për të siguruar ProCredit Bank. Këto të dhëna nuk u kalohen dhe transmetohen palëve të treta nëse nuk ka një detyrim ligjor për transmetimin e të dhënave, ose nëse transferimi dhe dhënia e të dhënave ndodh në funksion të qëllimit të ndjekjes penale.

Regjistrimi i subjektit të të dhënave, me tregues vullnetar të të dhënave personale, ka për qëllim që ProCredit Bank të ofrojë subjekteve të të dhënave përmbajtje ose shërbime që mund t'u ofrohen vetëm përdoruesve të regjistruar për shkak të natyrës së çështjes në fjalë. Personat e regjistruar janë të lirë të ndryshojnë të dhënat personale të përcaktuara gjatë regjistrimit në çdo kohë ose tu fshihen tërësisht të dhënat nga baza e të dhënave të ProCredit Bank.

ProCredit Bank, në çdo kohë, do të japë informacione sipas kërkesës të secilin subjekt të të dhënave në lidhje me arsyen e ruajtjes së të dhënave personale të subjektit e të dhënave. Përveç kësaj, ProCredit Bank do të korrigjojë ose fshijë të dhënat personale me kërkesë ose udhëzim të subjektit të të dhënave, për sa kohë që nuk ka detyrime në bazë të ligjit për ruajtjen e tyre. Personat e mëposhtëm nga banka janë në dispozicion të subjektit të të dhënave:

Ardit Pepa
ProCredit Bank Albania
Rr.Dritan Hoxha, Nd.92, H.15, Njesia Bashkiake Nr.11, Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 69 20 95 588
e-mail: Ardit.Pepa@procredit-group.com
website: www.procreditbank.com.al

Hermiona Jolle
ProCredit Bank Albania
Rr.Dritan Hoxha, Nd.92, H.15, Njesia Bashkiake Nr.11, Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 42 389 389
e-mail: Hermiona.Jolle@procredit-group.com
website: www.procreditbank.com.al

5. Mundësia e kontaktit nëpërmjet faqes sonë zyrtare në internet

Faqja e internetit të ProCredit Bank përmban informacione dhe të dhëna që mundësojnë një kontakt të shpejtë elektronik me ndërmarrjen dhe shoqërinë tonë, si dhe komunikim të drejtpërdrejtë me ne, i cili gjithashtu përfshin një adresë të përgjithshme të njohur si posta elektronike (adresë e-mail). Nëse një subjekt i të dhënave kontakton ProCredit Bank me e-mail ose nëpërmjet një formë kontakti, të dhënat personale të transmetuara nga subjekti i të dhënave ruhen automatikisht. Këto të dhëna personale të transmetuara në baza vullnetare nga subjekti i të dhënave në ProCredit Bank ruhen për qëllime përpunimi ose kontaktimit të subjektit të të dhënave. Këto të dhëna personale nuk transferohen drejt palëve të treta.